REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 948/20
Datë/Datum. 16.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNA E SUHAREKËS

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. AP: **624-20-5546-5-2-1 dhe numri i brendshem 624-20-104-521**

Sa i përket tenderit për Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve- Faza e Tretë- Përfundimtare

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"EKO TERM " SHPK & NNSH "Top Projekt" & Lirim Bujari B.I.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr. Brigada 123, pn, Suhareke

(Adresa)

Suhareke — *23000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

049 288 805 — /

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Bajram Beqaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ekotermshpk@hotmail.com

(Adresa elektronike)

16.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

EkoTerm SHPK SUHAREKË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate eshte shpallur me dt. 24.09.2020 *Dorezimi i tenderit eshte bere me dt. 05.10.2020 ne ora 14:00, dhe ne te njejten kohe eshte bere edhe hapja e tenderit.* *Njoftim permes plateformes elektronike mbi Vendimin e AK per tenderuesin e pasuksesshem dt. 30.10.2020 dhe njeherit Njoftimi per shperblim me kontrate te OE* *Kriteri per dhnje te kontrates:* Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët *Vendimi per refuzimin nga AK dt 06.11.2020*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Kemi bere kerkese per Rishqyrtim prane AK me dt 02.11.2020 ku i kemi prezantu faktet dhe arsyet rreth pakenaqesise sone, dispozitat e shkelura te LPP dhe njeherit kemi kerkuar qe AK te rishqyrtoje Njoftimin per dhenje te kontrates.
AK- na njofton me dt. 06.11.2020 me Vendimin mbi Refuzimin e Kerkeses tone per Rishqyrtim te dt. 02.11.2020

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 -	Qëllimi
Neni 7 -	Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 56 -	Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
Neni 59 -	Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 -	Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 66 -	Përshtatshmëria Profesionale
Neni 72 -	Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 108A-	Zgjidhja preliminare e mosmarrveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Permes plateformes elektronike te KRPP – se njoftohemi mbi Vendimin e Autoritetit Kontarktues me dt 30.10.2020, se per aktivitetin e prokurimit me titull: **Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve- Faza e Tretë- Përfundimtare**, me numer te prokurimit **624-20-5546-5-2-1** dhe numri i brendshem **624-20-104-521**, eshte shpallur fitues Operatori Ekonomik **NBT-ING Shpk.**

Te pakenaqur me kete vendim, ne baze te dispozitavete LPP-se, kemi bere kerkese per qasje ne dokumentacionin e tenderit fitues me dt. 30.10.2020 dhe po ne te njejten dite dt. 30.10.2020 ne ora 15:00 na eshte ofruar qasje ne dokumentacionin e tenderit , me qerast konstatojme se:

Gjate vlersimit te tenderit Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP-se respektivisht Neni 1, Neni 7 , Neni 56 , Neni 59, Neni 60 , Neni 66 dhe Neni 72 duke shpallur fitues Operatorin Ekonomik **NBT-ING Shpk.** duke mos respektuar Dispoziata e LPP-se, kryesisht Kriteret e FTD-se pika 30.1 **Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.**

Prova Materiale 1.

Ne letren standarde per tenderuesin e pasuksesshem dt 30.10.2020 thuhet: **Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye:** – I pakompletuar, ING e Arkitektures – Arzije Zeneli nuk ka referenca qe ka punuar ne Ministrin e cultures Rinis dh Sportit sipas CV-se
ING e Hidroteknikes – Zarife Sallahu, kontrata e punes e lidhur me daten 13.03.2018 nuk korespodon me CV-in e leshuar pasi qe ne CV eshte data qe ka fillu punen 01.03.2016

Ju njoftojme se ne Kriteret e FTD-se, nuk eshte kerkuar fare Referenca per inxhinere , shih me poshte kerkesat e FTD-se:
Kërkesa2 - OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur ne project -Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë (ose master ne ndertimtari) drejtimi konstruktiv, minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.
- Një (1) Inxhinier i Dip. i Arkitektures (ose master ne arkitekture) minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.
-Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik (ose master ne hidroteknik) minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.
-Një (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë (ose bachelor) me licence, minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.
Një (1) Inxhinier i dip.i Elektros (ose master) – minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit

Dëshmia2 - Kontrata e punës ose mareveshjet me inxhinierit, Diploma (dhe licensa per gjeodetin) e NOTERIZUAR dhe nga një CV.

Edhe pse nuk eshte kerkuar referenca, AK- eshte dashur siç keni vepruar ne nje rast tjeter te kerkoni sqarime dhe te na mundesoni te plotesojme dokumentacionin (Referencen e pakerkuar ne FTD), megjithate Ne kemi bere kerkese tek Arkitektja e cila me kerkese zyrtare eshte paisur me Reference nga ***Instituti i Kosoves per Mbrojtje te Monumenteve, prane MKRS-se*** nr 01-R/2020 dt 28.10.2020 me numer te protokollit 300 dt 28.10.2020.

Ne dokumentacionin e tenderit ne kemi dorezuar Kontarten, Referencen nga Kompania jone, listen e ATK-se ku deshmohet se punetorja eshte ne maredhenie pune me Kompanine tone, dhe Ne e kemi plotesuar kete kriter edhe pa Reference, mirepo per nderin tuaj po ju bashkangjisim edhe referencen e lartepermendur leshuar nga ***Instituti i Kosoves per Mbrojtje te Monumenteve, prane MKRS-se.***

Sa i perket Inxhinieres se Hidroteknikes Zarife Sallahu, ku thuhet se ING e Hidroteknikes – Zarife Sallahu, kontrata e punes e lidhur me daten 13.03.2018 nuk korespodon me CV-in e leshuar pasi qe ne CV eshte data qe ka fillu punen 01.03.2016, ju njoftojme se Zarife Sallahu eshte punetore- inxhinere e hidros ne Kompanine tone nga 01.03.2016 – vazhdon akoma me te cilen ju deshmojme me Listat e Atk-se per kete periudhe kohore dhe ka kontrate pune valide deri me 31.12.2020. Ju kujtojme se kontratat vazhdohen ne periudha te caktuara sipas marreveshjes.

Bashkangjitur gjeni listat e ATK-se 2016-2017-2018-2019-2020.

Prandaj pas sqarimeve qe po ju dergojme, kerkojme nga Ju qe Gjate Rivlersimit te na shperbleni me kontrate sepse Ne kemi dorezuar oferten me te ulet dhe te pergjegjshme.

Siq keni vleresuar edhe ju , në Noftimin mbi vendimin e AK-se, kompanite si me poshte jane te papergjegjshme :

NNP AS-ING eshte i papergjegjshem per arsye se : mungon sigurimi i tenderit,diplomat e noterizuara per inxhinerere, mungojne EN-ISO 9001 2015, EN-ISO 14001 2015, Certificate of conformity (cilesia e gurit),

" AAB CONSTRUCTION " SH.P.K eshte i papergjegjshem per arsye se : mungon sigurimi I tenderit, mungojne te gjithe Ingjinierat, po ashtu edhe qertifikatat ISO standarde

GOE Limit L&B sh.p.k.; EuroVia SH.P.K eshte i papergjegjshem per arsye se : I pakompletuar, ING i Hidroteknikes nuk ka referenca per pune sipas Cv-se se prezantuar, poashtu edhe noterisimi I diplomes nuk perputhet me te dhenat e personit ne fjale. Eshte kerkuar qe stafi teknik te ket 10 puntor, ndersa OE ka prezantuar 9 kontrata te te punesuarve dhe kontrata e punes per Milaim Zyrapi nuk eshte e nenshkruar.
Te paisjet per krejrjen e punimeve ne njoftim te kontrates eshte kerkuar 2 kamion te rende, ndersa OE ka prezantuar 1 kamion te rende.

N.P.T. "Bamirs", eshte i papergjegjshem per arsye se : I Pakompletuar, mungon sigurimi i tenderit, mungon qertifikata e konfirmitetit për cilsin e gurit.

Visar Kuçi B.I, eshte i papergjegjshem per arsye se : I Pakompletuar, mungon sigurimi i tenderit, mungojne ingjinierat per kryerjen e ketij projekti, po ashtu mungon qertifikata e konfirmitetit për cilësin e gurit.

Prandaj, duke shikuar te gjithe dokumentacionin e tenderit, ofertat e dorezuara nga Operatoret Ekonomik kerkojme nga Ju qe te beni Rishqyrtimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues te dates 30.10.2020 dhe NE te shpallemi fitues si Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e jnaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*